



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 1249, Prot.

Tiranë, më 22 / 12 / 2024

URDHËR

Nr. 1249, Datë 22 / 12 / 2024

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT PËR
PËRFSHIRJEN E KUALIFIKIMEVE PËR TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS NË
KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE, PËR NIVELET 2-5

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 5 të kreut IV, të Vendimit nr. 427, datë 26.06.2019 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, sipas niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, për arsimin dhe formimin profesional",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për funksionimin e Komisionit për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, për nivelet 2-5, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Blendi GONXHJA

RREGULLORE
PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT PËR PËRFSHIRJEN E KUALIFIKIMEVE
PËR TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS NË KORNIZËN SHQIPTARE TË
KUALIFIKIMEVE, PËR NIVELET 2-5

Neni 1
Objekti

Kjo Rregullore ka për objekt të përcaktojë mënyrën e funksionimit të Komisionit për vlerësimin e aplikimeve për përfshirjen e kualifikimeve të të nxënësve gjatë gjithë jetës, për nivelet 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, këtu e në vijim referuar shkurtimisht si Komisioni.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në Vendimin nr. 427, datë 26.06.2019 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënësve gjatë gjithë jetës, sipas niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), për arsimin dhe formimin profesional", Vendimin nr. 673, datë 16.10.2019 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve", i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)".

Neni 3
Ngritja dhe përbërja e Komisionit

1. Ngritja e Komisionit, përbërja emërore e tij, si dhe udhëzuesit metodologjik teknik për zbatimin e procesit të aplikimit për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënësve gjatë gjithë jetës, për nivelet 2-5, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, miratohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.
2. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) përfaqësues të AKAFPK dhe 1 (një) specialist i jashtëm.
3. Përbërja e Komisionit është si më poshtë vijon:
 - a) Drejtori i Drejtorisë së Profesionëve dhe Kualifikimeve Profesionale - kryetar
 - b) 1 (një) përfaqësues nga sektori i kualifikimeve profesionale - anëtar
 - c) 1 (një) përfaqësues nga sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së - anëtar
 - d) 1 (një) përfaqësues nga sektori i profesionëve - anëtar
 - e) 1 (një) specialist i jashtëm, i angazhuar nga AKAFPK-ja me kontratë shërbimi - anëtar
3. Specialisti i jashtëm, anëtar i Komisionit zgjidhet nga fusha përkatëse e kualifikimit për të cilin është bërë aplikimi.

4. Komisioni asistohet nga një punonjës nga sektori i shërbimeve mbështetëse dhe projekteve, i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e sekretariatit teknik, i cili nuk është anëtar i komisionit, por do të ofrojë mbështetje administrative gjatë procesit.

5. Në mbledhjet e Komisionit, mund të ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues nga Komiteti Sektorial, nëse ekziston një i tillë për sektorin ku përfshihet kualifikimi për të cilin është bërë aplikimi, përfaqësues nga organizata përfaqësuese të sektorit ku përfshihet kualifikimi, si dhe aplikanti për të dhënë shpjegime dhe informacion të mëtejshëm që lidhet me aplikimin. Të ftuarit nuk kanë të drejtë vote.

6. Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKAFPK për ngritjen e komisionit dhe përbërjen e tij përcakton dhe kohëzgjatjen e këtij komisioni.

Neni 4

Funksionet e Komisionit

1. Komisioni shqyrton aplikimet dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofruesit dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve dhe kërkesave ligjore për këtë proces.

2. Në përfundim të procedurës së vlerësimit, Komisioni merr vendim për miratimin ose refuzimin e aplikimit për përfshirjen e kualifikimit objekt vlerësimi në nivelin përkatës të KSHK.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Kryetari i Komisionit njofton anëtarët në lidhje me aplikimet e paraqitura nga ofruesit, si dhe datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes përkatëse të Komisionit.

2. Komunikimi me anëtarët e Komisionit mbahet me shkrim, nëpërmjet postës elektronike.

3. Komisioni mund të mbledhet dhe më shumë se një herë për të njëjtin aplikim.

4. Në rast të mangësive të vërejtura në dokumentacion, Komisioni mund t'i kërkojë ofruesit plotësimin e dokumentacionit, brenda një afati 10 (dhjetë) ditë kalendarike.

5. Në çdo rast, vendimi i Komisionit për pranimin apo refuzimin ose kërkesa për dokumentacion ose informacion shtesë në lidhje me aplikimin, i njoftohet aplikantit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit apo konstatimit dhe jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e aplikimit.

Neni 6

Mbledhjet e Komisionit

1. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur marrin pjesë të paktën 4 (katër) anëtarë nga të cilët njëri të jetë specialist i jashtëm.

2. Në rastin se, nuk arrihet pjesëmarrja e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mbledhja e Komisionit shtyhet për një datë tjetër të afërt.

3. Mbledhjet e Komisionit, si dhe diskutimet përgjatë procesit të vlerësimit së bashku me informacionin për votimin e rekomandimit, reflektohen në minutat e takimit, të cilat mbahen nga përfaqësuesi i sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe projekteve të AKAFPK-së. Procesverbali nënshkruhet nga pjesëmarrësit.

4. Komisioni i merr vendimet me shumicë votash.

5. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, vota e kryetarit të Komisionit është përcaktuese.

Neni 7

Përfshirja e kualifikimeve të të nxënit gjatë gjithë jetës në KSHK

1. Përfshirja e kualifikimeve të të nxënit gjatë gjithë jetës në KSHK bazohet në përputhjen e kualifikimeve të të nxënit gjatë gjithë jetës me standardet e kualifikimeve profesionale ekzistuese, për kualifikime të ofruara për më shumë se 125 orë, të cilat janë pjesë e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale sipas niveleve 2-5 të KSHK-së të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional.

2. Thirrja për aplikim publikohet në faqen zyrtare të internetit të AKAFPK-së dhe përmban afatin maksimal të aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, që duhet të dorëzohet nga aplikantët.

3. Sekretariati teknik, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e pranimit të kërkesës, shqyrton përmbushjen e kërkesave të aplikimit, në bazë të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues të dorëzuar, dhe ia përcjell Komisionit.

4. Nëse aplikimi ka pasaktësi ose mungesa, sekretariati i kërkon ofruesit të AFP-së që të bëjë ndryshimet/plotësimet e nevojshme në dokumentacion.

5. Komisioni shqyrton dhe merr vendim në lidhje me përfshirjen e kualifikimeve të të nxënit gjatë gjithë jetës, sipas procedurave dhe kriterëve të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe në udhëzuesin metodologjik teknik për përfshirjen e kualifikimeve të të nxënit gjatë gjithë jetës në KSHK, që përfshin formularët e nevojshëm për të lehtësuar procesin e aplikimit dhe vlerësimit dhe miratohet nga AKAFPK.

6. Vendimet e Komisionit i paraqiten për miratim Titullarit të AKAFPK-së.

7. Titullari i AKAFPK-së miraton vendimet për pranimin ose refuzimin e kërkesës së aplikantit, brenda 3 (tre) ditëve pune pas njoftimit nga Komisioni dhe njofton zyrtarisht ofruesin e AFP-së, duke shpjeguar arsyet përkatëse, në rast refuzimi.

8. Ofruesi i AFP-së, ka të drejtën e marrjes së informacionit dhe të ankimeve vendimin e Komisionit. Procedura e ankimit ndjek rregullat e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

9. Në rastin e marrjes së vendimit të miratimit të aplikimit për përfshirjen në nivelin përkatës të KSHK të kualifikimit objekt vlerësimi, AKAFPK lëshon vërtetimin për përcaktimin e nivelit përkatës të KSHK-së, dhe kjo i përcillet ministrisë përgjegjëse për AFP për dijeni. Format i vërtetimit përcaktohet në udhëzuesit metodologjik teknik për zbatimin e procesit të aplikimit për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës të miratuar në AKAFPK.

10. Drejtorja e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale mban regjistrin e subjekteve dhe kualifikimeve për të cilat është pranuar përfshirja e kualifikimeve gjatë gjithë jetës në KSHK.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

1. Ofruesit e AFP-së, të cilëve ju është miratuar aplikimi për përfshirjen e kualifikimeve të të nxënëit gjatë gjithë jetës në KSHK, do të konsiderohen të kualifikuar për të ofruar programe të tilla pasi të kryejnë me sukses procesin e akreditimit të zbatuar nga AKAFPK.

2. Udhëzuesi metodologjik teknik në lidhje me procesin e aplikimit për përfshirjen e kualifikimeve të të nxënëit gjatë gjithë jetës, për nivelet 2-5, në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i AKAFPK, brenda 3 (tre) muajve, nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.